



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE

SEKTORI JURIDIK



Nr. 177/1 prot.

Tiranë, më 22/02/2020.

URDHËR

Nr. 22, Datë, 24/02/2020

MBI

**DISA MASA PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE
ORGANET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 39 (Rektori), nenin 131, të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikë ne Shqipërisë", Urdhrit nr. 8, datë 14.01.2020, të MASR, "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë", Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", miratuar me VSA nr. 19. 02.2020,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve, në datën **09/04/2020**;
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve, është data **08/05/2020**;
3. Senati Akademik, **brenda datës 06/03/2020**, zgjedh me votim të fshehtë, anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), me përfaqësues nga çdo fakultet dhe studentët. Senati cakton edhe sekretarin e KIZ, i cili është anëtar patë drejtë vote pranë KIZ. Dekanët e fakulteteve, brenda afateve të përcaktuara, të organizojnë punën në zbatim të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", për të sensibilizuar personelin akademik.
4. Në zbatim të nenit 11 (Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve), të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve", DMBNJ pranë rektoratit të UART në bashkëpunim me departamentet pranë fakulteteve, të hartojnë listat e zgjedhjeve për personelin akademik, të punësuar më kohë të plotë, **brenda datës 07/04/2020**;

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri | Tel: +355 42 225 488 | www.uart.edu.al

URDHËR

Nr. 22, date 24/02/2020





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE

SEKTORI JURIDIK



Sekretaritë mësimore, pranë fakulteteve, të hartojnë listëne zgjedhësve për studentët brenda **datës 07/04/2020**;

5. Emrat kandidatë për anëtar të KIZ, që do të zgjidhen nga Senati Akademik, nuk duhet të jenë nga anëtarët e personelit akademik ose student, që do të vetëkandidohen për autoritetet drejtuese ose në organet drejtuese në UART;
6. Në zbatim të nenit 37, (*Komisioni i Apelimit*), të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin e Arteve”, Senati Akademik **brenda datës 06/03/2020**, zgjedh anëtarët e Komisionit të Apelimit;
7. Administratori i UART të vendosë në dispozicion të komisioneve të zgjedhjeve dhe Komisionit të Apelit ambientet dhe bazën materiale të nevojshme për mirëfunksionimin e gjithë procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në UART.
8. I gjithë dokumentacioni zgjedhor, duke filluar nga ky urdhër dhe deri në përfundim të procesit të zgjedhjeve të ruhet në bazë të rregullave në kuadrin ligjor për administrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit;
9. Ngarkohen në zbatimin e këtij urdhri, i gjithë personeli akademik, studentët, punonjësit e administratës, autoritetet drejtuese në UART.
10. Ky urdhër, të shpallet në të tre fakultetet dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Kastriot ÇAUSHI